



MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ANALIZË STATISTIKORE **NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore

MAJ 2025

Botim i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjeti apo formë

Tabela e përmbajtjes

H Y R J E	6
KREU I - TË DHËNA STATISTIKORE MBI NDIHMËN JURIDIKE PARËSORE	8
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore – Maj 2025.....	8
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara – Maj 2025	15
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve- Maj 2025	22
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010 – Maj 2025	23
Platforma Juristionline.....	23
Numri i Gjellbër 08001010	23
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo Ofrues i Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore- Maj 2025	24
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas moshës mestare)	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas arsimit)	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas punësimit)	26
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)	26
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese)	26
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara për kategorinë e veçantë “i mitur” nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore Maj 2025	28
KREU II: TË DHËNA STATISTIKORE MBI NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE	29
Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike dytësore, sipas:	29
Ndarjes gjinore, Gra dhe Burra	29
Kategorisë përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë	29
Arsimit të kërkuesve, të vendimeve gjyqësore me objekt kërkesën e ndihmës juridike	31
Punësimit të kërkuesve, të vendimeve gjyqësore me objekt kërkesën e ndihmës juridike	31
Mosha mesatare e kërkuesve	31
Llojit të ndihmës dytësore të ofruar	32

Vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.	32
Llojit të çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike	33
Gjykatës që kanë dhënë vendimin.	34
KREU III - INFORMACION MBI BUXHETIN	35
Të dhëna statistikore mbi pagesat e përfaqësimit të avokatëve të ndihmës juridike dytësore si dhe shpenzimet gjyqësore të likujduara Janar – Dhjetor 2025.	35
KREU IV- KONKLUZIONE - MUAJI MAJ 2025	36
Sa i përket Ndhmës Juridike Parësore	36
Sa i përket Ndhmës Juridike Dytësore	36
Sa i përket Buxhetit të shpenzuar për likujdimin e vendimeve gjyqësore, si dhe shpenzimeve gjyqësore të likujduara.....	37
KREU V - NDIHMA JURIDIKE PARËSORE DHE DYTËSORE “JANAR- DHJETOR 2025”	38
Të dhëna statistikore nga çdo ofrues i Ndhmës Juridike Parësore, për çdo muaj, për periudhën Janar – Dhjetor 2025.	38
Të dhëna statistikore mbi totalin e rasteve të raportuara nga secili ofrues i Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, për çdo muaj.	38
Të dhëna statistikore mbi totalin e Kërkesave për ndihmë juridike dytësore, për çdo muaj, për periudhën Janar – Dhjetor 2025.....	42
Të dhëna statistikore sipas objektit të kërkesës për Ndhmë Juridike Dytësore dhe vendimmarrjes së gjykatës	42
Të dhëna statistikore mbi numrin e vendimeve gjyqësore nga çdo Gjykatë, për çdo muaj.	43
Të dhëna statistikore mbi likujdimin e ofruesve të ndihmës juridike dytësore Janar – Dhjetor 2025	44
Të dhëna statistikore mbi numrin e total të qytetarëve që kanë përfituar Ndhmë Juridike Parësore/ Dytësore, Janar – Dhjetor 2025	45
Sipas gjinisë.....	45
Sipas moshës mesatare	45
Sipas arsimit.....	45
Sipas punësimit.....	45
Sipas natyrës së çështjes	46
Sipas kategorive përfituese të përcaktuara në ligj	46
Të dhëna statistikore mbi viktimat e krimit, ndihma juridike parësore dhe dytësore Janar- Dhjetor 2025.....	48
Të dhëna statistikore mbi viktimat e krimit, për ndihmën juridike parësore, raportuar nga çdo ofrues shërbimi.	48
Të dhëna statistikore mbi viktimat e krimit, për ndihmën juridike dytësore.....	48

Të dhëna statistikore mbi të miturit, përfitues të ndihmës juridike parësore dhe dytësore Janar- Dhjetor 2025.....	49
Të dhëna statistikore mbi të miturit, për ndihmën juridike parësore, raportuar nga çdo ofrues shërbimi.	49
Të dhëna statistikore mbi të miturit, për ndihmën juridike dytësore.....	49
Kontribute dhe Raportime të DNJF-së në kuadër të proceseve strategjike Janar- Dhjetor 2025	50

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike, ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfundimin e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr. 111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”**.

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjukata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;

- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistrë, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I - TË DHËNA STATISTIKORE MBI NDIHMËN JURIDIKE PARËSORE

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore – Maj 2025

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (*përmes punonjësve me trajnim të posaçëm*); Organizatat jofitimprurëse të autorizuar dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (*ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare*) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 14 (katërmëdhjetë) Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore si vijon:

1. **Tiranë** (*me buxhetin e shtetit*);
2. **Durrës** (*me buxhetin e shtetit*);
3. **Lushnjë** (*me buxhetin e shtetit*);
4. **Shkodër** (*me buxhetin e shtetit*);
5. **Tropojë** (*me buxhetin e shtetit*);
6. **Përmet** (*me buxhetin e shtetit*);
7. **Pukë** (*me buxhetin e shtetit*);
8. **Mat** (*me buxhetin e shtetit*);
9. **Kavajë** (*me buxhetin e shtetit*);
10. **Kurbin** (*me buxhetin e shtetit*);
11. **Gjirokastrë** (*me buxhetin e shtetit*);
12. **Fier** (*me buxhetin e shtetit*);
13. **Korçë** (*me buxhetin e shtetit*);
14. **Vlorë** (*me buxhetin e shtetit*);

Pas përfundimit të mbështetjes financiare nga UNDP/ADA (Shkurt 2025) për 6 (gjashtë) Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Pogradec, Dibër, Elbasan, Berat, Kukës dhe me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr. 47, datë 13.03.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Urdhrin nr.21, datë 01.03.2023, të Kryeministrit së Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukture dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, është miratuar shtimi i numrit të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (16 qendra me nga 1 punonjës dhe 4 qendra me nga 2 punonjës (24 punonjës në total). Proçesi i rekrutimit të punonjësve për 6 (gjashtë) Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Pogradec, Dibër, Elbasan, Berat, Kukës ka përfunduar dhe funksionimi i plotë i tyre ka nisur në datën 28.05.2025.


Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Mosha			Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Refuzimi të ndihmës juridike falas (Nuk janë subjekte të ligjit nr.111/2017)
		Mitur	Rritur	Mosha mesatare	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative	Romë & Egjiptian	
Tiranë	38	1	37	56	22	16	37	1	27	11 (9 Person me aftësi të kufizuar, i mitur në konflikt me ligjin, 1 viktimë e trafikut të qënieve njerëzore)	0	23	6	9	0	0
Durrës	9	0	9	47	8	1	9	0	6	3 (2 viktima të dhunës në familje, 1 Person me aftësi të kufizuar)	0	7	0	2	0	0
Lushnjë	12	0	12	45	10	2	12	0	5	7 (4 viktima të dhunës në familje, 2 Person me aftësi të kufizuar, 1 Përfitues i ndihmës ekonomike)	0	9	2	1	0	0
Shkodër	28	0	28	52	16	12	28	0	22	6 (3 Person me aftësi të kufizuar, 2 Viktima të dhunës në familje, 1 Përfitues i ndihmës ekonomike)	0	26	1	1	0	0
Tropojë	42	0	42	62	17	25	40	2	25	17 (5 Persona me aftësi të kufizuar, 12 Përfitues të skemave social)	0	14	0	28	0	0
Përmet	5	0	5	65	2	3	5	0	1	4 (3 Përfitues të skemave sociale, 1 person me aftësi të kufizuar)	0	2	0	3	1	0
Pukë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mat	10	0	10	50	3	7	10	0	5	5 (2 Person me aftësi të kufizuar, 3 Përfitues nga skemat sociale)	0	2	0	8	0	0
Kavajë	1	0	1	29	1	0	1	0	0	1 Përfitues nga skemat sociale	0	1	0	0	0	-
Kurbin	5	0	5	52	3	2	5	0	3	2 (1 Person me aftësi të kufizuar, 1 viktimë e dhunës në familje)	0	5	0	0	0	0

Lezhë	4	0	4	52	2	2	4	0	3	1 Person me aftësi të kufizuar	0	0	0	4	0	0
Gjirokastrë	34	0	34	57	17	17	34	0	23	11 (5 Persona me aftësi të kufizuar, 4 Viktimë të dhunës në familje, 2 Përfitues të ndihmës ekonomike)	0	13	5	16	11	0
Pogradec	5	0	5	58	3	2	5	0	3	2 (1 përfitues i statusit të verbërisë, 1 Përfitues të ndihmës ekonomike)	0	4	0	1	0	0
Fier	20	0	20	52	15	5	20	0	16	3 (1 viktimë e dhunës në familje, 2 Persona me aftësi të kufizuar)	1	13	0	7	5	0
Dibër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlorë	17	0	17	51	6	11	17	0	16	1 Persona me aftësi të kufizuar	0	1	0	16	4	0
Elbasan	10	0	10	55	3	7	10	0	3	7 (2 Person me aftësi të kufizuar, 5 Përfitues nga skemat sociale)	0	2	1	7	1	0
Berat	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kukës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Korçë	21	0	21	64	8	13	21	0	14	7 Person me aftësi të kufizuar	0	18	0	3	3	0
TOTALI	261	1	260	52	136	125	258	3	172	88	1	140	15	106	25	0

Për muajin Maj 2025 janë administruar 261 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore¹


¹ Numri i rasteve të trajtuara për muajin Maj 2025, për 6 (gjashtë) Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë, Pogradec, Dibër, Elbasan, Berat, Kukës është më i ulët për shkak se funksionimi i plotë i tyre ka nisur në datën 28.05.2025, pas përfundimit të mbështetjes financiare nga UNDP/ADA, deri në muajin Shkurt 2025.

Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në formë grafike, Maj 2025:




Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, pasqyruar në përqindje (%), Maj 2025.


Sipas Gjinisë




Sipas Arsimit




Sipas Punësimit




Sipas Natyrës së çështjes



Sipas Kategorive Përfituese



Kategoritë e veçanta përfituese, sipas ligjit



Kategoria e veçantë	Nr. i përfituesve në total nga QSHNJP-të 2025												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Viktima të dhunës në familje	15	14	10	16	14								69
Viktima të abuzuar seksualisht													
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore					1								1
Viktima të mitur					1								1
Të mitur në konflikt me ligjin		1	1										2
Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore													
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Personat që përfitojnë nga pagesa për aft.e kufizuar	48	44	28	30	42								192
Statusi i të verbrit	2	1	1	2	1								7
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në inst. e shërbimit të shëndetit mendor													
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor				4									4
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja, kufizimi i zotësisë për të vepruar		1											1
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	27	14	20	19	27								107
Përfitues të ndihmës ekonomike	7	5	4	3	2								21
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim													
Nr. Total i përfituesve sipas kategorisë së veçantë - 2025	99	80	64	74	88								405
Pensionistë	0	79	46	60	67								252
Nr. Total i përfituesve Romë/egjiptiane - 2025	24	16	10	18	25								93
Nr.Total i të miturve	0	2	1	1	1								5

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara – Maj 2025

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura e dhënies të autorizimeve për periudhën 2024-2026, ka përfunduar në muajin Tetor 2024, përmes lëshimit të Urdhrave të Ministrit të Drejtësisë për **14 (katërmëdhjetë) Organizata Jofitimprurëse**, si vijon:

1. **Forumi i Gruas Elbasan (FGE)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Shpresa Banja.
2. **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Aurela Bozo.
3. **Qendra Psiko-Sociale Vatra**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Brikena Puka
4. **Qendra e Gruas Hapa të Lehtë**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Denada Shpuza.
5. **Qendra ALTRI**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Eda Noçka.
6. **Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Iris Luarasi
7. **Shoqata “Mbrotja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Artë Dymishi
8. **Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Mariana Hereni
9. **Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Elona Hoxha.
10. **Qendra “Konsumatori Shqiptar”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Ersida Teliti.
11. **Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Anjeza Puka.
12. **Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Marjana Meshi.
13. **Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Rajmonda Bozo.
14. **Instiuti i migracionit, zhvillimit dhe integritetit (IMZHI)**, Dr.ekzekutiv: z.Enkelejt Avdyli


OJF e Autorizuar	Total i Rasteve	Mosha				Gjinia			Shtetësia				Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes				Përkatësia etnike Rom, egjipt.
		Mitur	Rritur	Pa-përcaktuar	Moshamesatare	Femër	Mashkull	Pa-përcaktuar	Shqiptar	Ihuaj	Pashtetësi	Papërcakt.	Të ardhura & pasuri të përmjaftueshme	Kategori e Veçantë	Pa-përcakt.	Civile	Penale	Administrative	Pa-përcakt.	
1 . “Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajza”	17	1	16	0	35	16	1	0	17	0	0	0	0	17 (16 Viktima të dhunës në familje, 1 viktimitë e mitur)	0	12	5	0	0	
2 . “Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
3. “Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara” QSHPLI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4 . “Qendra Vatra”	20	2	18	-	32	18	2	-	13	7	-	-	1	19 (10 Viktima të dhunës në familje, 7 Viktima të mundshme të trafikimit, 1 viktimitë e abuzimit seksual, 1 viktimitë e mitur)	0	12	8	0	0	
5. Instiuti i migracionit, zhvillimit dhe integritimit IMZHI	4	0	4	0	67	0	4	0	4	0	0	0	4	0	0	4	0	0	0	
6. “Forumi i Gruas Elbasan”	8	0	8	0	39	8	0	0	8	0	0	0	1	7 (4 Viktima të dhunës në familje, 1 PAK, 2 skema e mbrotjtjes sociale)	0	8	0	0	0	2 egjipt
7. “Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	25	13	12	0	30	18	7	0	25	0	0	0	9	16 (3 Viktima të dhunës në familje, 1	0	14	2	9	0	14 rom 3 egjipt

														PAK, 12 Skema e mbrojtjes sociale)						
8. “Të ndryshëm dhe të barabartë”	21	3	18	0	28	20	1	0	18	3	0	0	0	21 (14 Viktima të dhunës në familje, 6 viktima të trafikimit, 1 viktime e abuzimit seksual)	0	14	3	4	0	
9. “Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)	4	0	4	0	32	3	1	0	4	0	0	0	0	0	4	0	0	4	0	
10. “Qendra për nisma ligjore qytetare” QNL	23	0	20	3	35	21	2	0	23	0	0	0	9	14 (1 PAK, 13 Viktima të dhunës në familje)	0	19	1	3	0	
11. “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët” RMSA	10	0	10	0	33	4	6	0	0	10	0	0	0	0	10	0	0	10	0	
12. “Qendra Konsumatori Shqiptar”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
13. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
14. Qendra e Gruas “Hapa të lehtë”	6	0	6	0	44	6	0	0	6	0	0	0	6	0	0	6	0	0	0	
TOTALI	138	19	116	3	35	114	24	0	118	20	0	0	30	94	14	89	19	30	0	14 rom/ 5 egjip

Për muajin Maj 2025 janë administruar 138 raste nga OJF-të e autorizuar


Shënim: Organizatat jofitimprurëse, “ACPD”, “QSHPLI”, “Qendra Konsumatori Shqiptar” dhe “Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat” nuk kanë raportuar për muajin Maj 2025

Rastet e raportuara nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara në formë grafike, Maj 2025:




Rastet e raportuara nga Organizatat Jo-fitimprurëse pasqyruar në përqindje (%), Maj 2025


Sipas Gjinisë




Sipas Arsimit




Sipas Punësimit




Sipas Natyrës së çështjes



Sipas Kategorive Përfituese



Kategoritë e veçanta përfituese, sipas ligjit



Kategoria e veçantë	Nr. i përfituesve në total nga OJF-të - 2025												
	Janar	Shkur t	Mars	Prill	Maj	Qersh or	Korri k	Gusht	Shtat or	Tetor	Nënto r	Dhjet or	Total
Viktima të dhunës në familje	71	66	75	58	60								330
Viktima të abuzuar seksualisht	1			3	2								6
Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	5	8	11	15	13								52
Të mitur si kategori e veçantë		1			2								3
Të mitur në konflikt me ligjin				1									1
Fëmijët, të cilët jetojnë në inst. e përkujdesjes shoq.													
Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa miratimin/kundër kujdestarit të tyre													
Personat që përfitojnë nga PAK/ KMCAP	4			3	3								10
Statusi i të verbrit			1										1
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në inst. e shërbimit të shëndetit mend.													
Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor													
Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja/kufizimi i zotësisë për të vepruar													
Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	3	1		3	14								21
Përfitues të ndihmës ekonomike													
Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor													
Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim													
Kategori e veçantë, por e papërcaktuar në raportim		1	4										5
Nr. Total i përfituesve sipas kategorisë së veçantë - 2025	84	77	91	83	94								429
Pensionistë													
Nr. Total i përfituesve Romë/egjiptiane	9	4	0	13	19								45
Të mitur total	21	19	15	13	19								87

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve- Maj 2025

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me **13 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan** konkretisht:

1. **Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;**
2. **Klinika e Ligjit Shkodër, Universiteti “Luigj Gurakuqi”;**
3. **Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
4. **Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
5. **Universiteti European i Tiranës;**
6. **Universiteti “Qirjazi”;**
7. **Universiteti “Bedër”;**
8. **Universiteti “Mesdhetar”;**
9. **Universiteti “Marin Barleti”;**
10. **Universiteti “Luarasi”;**
11. **Universiteti “Epoka”;**
12. **Universiteti “Aleksander Xhuvani”;**
13. **Universiteti “Albanian University”**

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutur ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues. Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuar do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin Maj 2025 janë administruar 0 raste nga Klinikat e Ligjit

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010 – Maj 2025

Platforma Juristionline

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar **për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojëshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh, të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

RASTET E TRAJTUARA nga Platforma Juristi Online

Maj 2025 –30 raste


Numri i Gjelbër 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion **një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike**. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. ***Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.***

NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)

TOTALI I RASTEVE - TELEFONATAVE ËSHTË 23

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo Ofrues i Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore- Maj 2025



**Totali i rasteve të trajtuara nga Ofruesit e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore për muajin
Maj 2025 – 399 raste²**


² Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Maj 2025, duke përfshirë Platformën Juristi Online, si dhe Nr. e Gjellbër është 452 raste. Për muajin Maj 2025, funksionimi i plotë i 6 Qendrave (Lezhë, Pogradec, Dibër, Kukës, Berat dhe Elbasan) filloi më 28.05.2025.

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas moshës mestare)

	QSHNJP	OJF	Klinika e Ligjit	Total
Mosha Mesatare	53	35	0	43


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)

	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Klinika e Ligjit	Nr. Total
Femra	136	114	0	250
Meshkuj	125	24	0	149
Papërcaktuar	0	0	0	0




Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas arsimit)

	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Nr. Klinkat e Ligjit	Nr.Total
Pa arsim	13	15	0	28
Arsim 8 vjeçar	138	70	0	208
Arsim i mesëm	87	31	0	118
Arsim i Lartë	22	20	0	42
Papërcaktuar	1	2	0	3




Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas punësimit)

	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Nr. Klinkat e Ligjit	Nr.Total
I punësuar	195	45	0	240
Pa-punë	53	90	0	143
Papërcaktuar	13	3	0	16




Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)

	Nr.QSHNJP	Nr.OJF	Nr. Klinkat e Ligjit	Nr.Total
Civile	140	89	0	229
Penale	15	19	0	34
Administrative	106	30	0	136
E papërcaktuar	0	0	0	0



Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese)



Përfituesit sipas kategorisë përfituese		QSHNJP	OJF	Klinika Ligjit	Total
1	Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	172	30	0	202
2	Kategoritë e veçanta përfituese	88	94	0	182
	Viktima të dhunës në familje	14	60		74
	Viktima të abuzuar seksualisht		2		2
	Viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	1	13		14
	Të mitur, si kategori e veçantë	1	2		3
	Të mitur në konflikt me ligjin				
	Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoq.				
	Fëmijët nën kujdestari, të cilët kanë nisur një proces pa/ kundër miratimit e kujdestarit të tyre ligjor				
	Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, KMCAP.	42	3		45
	Statusi i të verbrit	1			1
	Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor				
	Personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor				
	Personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar				
	Personat të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike	2			2
	Personat, përfitues të skemave të mbrojtjes sociale	27	14		41
	Persona, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor				
	Persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi/mosveprimi që përbën diskriminim				
	Kategori e veçantë, por e papërcaktuar kategoria				
	Pensionistë	67	0		67
3	Të paidentifikuar	1	14	0	15

Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara për kategorinë e veçantë “i mitur” nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore Maj 2025

Të miturit- përfitues të ndihmës juridike parësore Maj 2025														
Kategoria e rastit	Total	Gjinia		Shtetësia			Përkatësia në një pakicë kombëtare				Aftësi e kufizuar		Grupmosha	
		Meshkuj	Femra	Shqiptare	Tjetër (Pa shtetësi/ e huaj)	Papërcakt.	Romë	Egjiptianë	Maxhoritar	Papërcakt	Po	Jo	0-14	14-17
Penale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Civile	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Administrative	1	1	0	1	0	0	0	0	1	0	0	1	0	1
TOTALI Qendrat	1	1	0	1	0	0	0	0	1	0	0	1	0	1
Penale	4	2	2	4	0	0	2	0	2	0	0	1	1	3
Civile	8	3	5	8	0	0	4	1	3	0	0	8	6	2
Administrative	7	3	3	7	0	0	4	0	3	0	0	7	5	2
TOTAL OJF	19	8	11	19	0	0	10	1	8	0	0	19	12	7
TOTAL Klinikat e Ligjit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total Parësore Maj 2025	20	9	11	20	0	0	10	1	9	0	0	20	12	8


KREU II: TË DHËNA STATISTIKORE MBI NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike dytësore, sipas:

Ndarjes gjinore, Gra dhe Burra


Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, gjatë muajit Maj 2025, rezulton se për 73 vendime gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, 39 prej tyre rezultojnë për kërkuese gra, 34 prej tyre për kërkuese burra. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare dhe në përqindje (%), si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuësit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra – Maj 2025		
Kategoria Gra / Burra	Numri i kërkuësve	Komente / të tjera
Kërkuës Gra	39	Kërkuësit e ndihmës juridike falas për muajin Maj 2025, janë më shumë kërkuëse gra, se kërkuës burra.
Kërkuës Burra	34	
I Papërcaktuar	-	
TOTALI = 73 Vendime Gjyqësore		



Kategorisë përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas gjatë muajit Maj2025, rezulton se nga 73 vendime gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, 30 prej tyre rezultojnë për kërkuës që pretendojnë se i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme, 43 prej tyre rezultojnë nga kërkuës që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare dhe në përqindje (%), si vijon:




